

Raporti i DASH-it mbi terrorizmin, 2 qershor, 2016

pjesa për Kosovën

KOSOVË

Përmbledhje: Kërcënimi i ekstremizmit të dhunshëm islamik është rritur ngadalë në Kosovë që nga konflikti i vitit 1999, i ndihmuar pjesërisht përmes financimit nga organizatat e huaja që predikojnë ideologji ekstremiste. Rreth 250 – 300 luftëtarë të huaj terroristë nga Kosova kanë udhëtuar në Siri dhe Irak për të luftuar për Shtetin Islamik të Irakut dhe Levantit (ISIL) ose Frontin al-Nusrah, prej të cilëve rreth 50 janë vrarë. Grupet e dhunshme ekstremiste kanë përdorur në mënyrë aktive mediet sociale për ta përhapur propagandën dhe për të rekrutuar përkrahës. Asnjë incident terrorist nuk ka ndodhur në Kosovë gjatë vitit 2015, ndonëse policia ka arrestuar të dyshuar për planifikim të sulmeve të tilla. Në shtator, Qeveria e Kosovës miratoi strategjinë gjithëpërfshirëse dhe planin e veprimit për luftim të ekstremizmit të dhunshëm (CVE). Strategjia dhe plani i veprimit për CVE ofrojnë një plan pesë-vjeçar për frenimin e kërcënimit në rritje e sipër të ekstremizmit të dhunshëm përmes një qasjeje mbarë qeveritare, duke theksuar rolin kritik të palëve të interesuara lokale dhe të shoqërisë civile. Ndërsa palët e interesuara relevante qeveritare dhe joqeveritare kanë shprehur gatishmërinë dhe përkushtimin për zbatimin e agjendave të tyre përkatëse të veprimit, mungesa e kapaciteteve dhe e buxhetit të mjaftueshëm kanë mbetur sfida. Financimi për CVE, i vënë në dispozicion përmes përcaktimit të Kosovës si vend pilot për Fondin global të angazhimit dhe aftësinë ripërtëritëse të komunitetit (GCERF), mund ta forcojë dukshëm kapacitetin e qeverisë për ta zbatuar planin e saj të veprimit për CVE, por procesi do të kërkojë angazhim të ngushtë të SHBA-së për të siguruar që qeveria i përmbush afatet dhe standardet e rrepta që kërkohen për ta maksimalizuar ndarjen e saj të fondeve në dispozicion për GCERF-në. Drejtoria kundër Terrorizmit e Policisë së Kosovës është duke i rritur kapacitetet e veta hetimore përmes shtimit të numrit të personelit dhe duke zhvilluar një njësi kundër terrorizmit kibernetik.

Qeveria e Kosovës ka vazhduar bashkëpunimin kundër terrorizmit me Shtetet e Bashkuara. Shtetet e Bashkuara kanë mentoruar dhe ndihmuar institucionet për zbatimin e ligjit dhe institucionet gjyqësore në raste aktive kundër terrorizmit. Nëpërmjet Programit për kontroll të eksportit dhe siguri kufitare (EXBS), Programit ndërkombëtar për ndihmë dhe trajnim në hetime penale (ICITAP), Programit për zhvillim, ndihmë dhe trajnim prokurorial jashtë vendit (OPDAT) dhe Zyrës për bashkëpunim në çështje të mbrojtjes (ODC), Shtetet e Bashkuara kanë ofruar mundësi trajnimi në aspekte të ndryshme të kundërterrorizmit dhe CVE-së .

Pasi situata politike dhe e sigurisë në Kosovën veriore vazhdoi ta kufizonte mundësinë e qeverisë për ta ushtruar autoritetin e vet në atë pjesë, Forca e NATO-s për Kosovën (KFOR) dhe Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit (EULEX) punuan me Policinë e Kosovës për ta mbajtur një mjedis të qetë e të sigurt dhe për ta forcuar sundimin e ligjit, përfshirë atë në kufij. Mundësia e Kosovës për ta ushtruar autoritetin e vet në veri është përmirësuar që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit në vitin 2013 për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë, por të dy vendet duhet ta zbatojnë plotësisht këtë marrëveshje. Ndonëse Kosova dhe Serbia fqinje zakonisht nuk bashkëpunojnë në çështje të kundërterrorizmit, qeveritë kanë pasur një plan për menaxhim të integruar të kufirit (MIK) që nga viti 2013 dhe kanë marrë pjesë në trajnime të përbashkëta të sponsorizuara nga Qeveria e SHBA-së.

Kosova është anëtare e koalicionit global kundër ISIL-it dhe ka ndërmarrë masa për t'i mbështetur përpjekjet e ndryshme brenda kufijve të mundësive të saj. Ajo është përqendruar kryesisht në pengimin e rrjedhës së luftëtarëve të huaj terroristë dhe në zbulimin dhe kufizimin e financimit për grupe terroriste. Kosova nuk është anëtare e OKB-së, megjithatë, Qeveria e Kosovës është zotuar t'i zbatojë në mënyrë unilaterale Rezolutat 2170 dhe 2178 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Incidentet terroriste në vitin 2015: PK arrestoi 5 shqiptarë të Kosovës më 11 korrik të cilët përpiqeshin ta helmonin burimin kryesor të ujit të Prishtinës, liqenin e Badovcit. Policia arrestoi tre meshkuj pasi policët që patrullonin rezervarin i panë duke u sjellë në mënyrë të dyshimtë në brigje të liqenit. PK më pas i arrestoi dy të dyshuarit e tjerë. Dy prej të dyshuarve kishin luftuar për ISIL-in në Siri. Që të pestët u akuzuan për vepra terroriste.

Legjislacioni, zbatimi i ligjit dhe siguria kufitare: Korniza legjislative e Kosovës mjafton për t'i ndjekur penalisht individët të cilët dyshohen se kanë kryer ose mbështesin aktivitete terroriste, por prokurorët nuk kanë përvojë në trajtimin e rasteve të tilla. Zyrtarët e Kosovës pranojnë nevojën për ta përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet agjencive.

Kosova ka një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore që i mbulon të gjitha aspektet kriminale që lidhen me terrorizmin. Kodi Penal i Kosovës ndjek modelin e OKB-së për legjislacion penal kundër terrorizmit dhe i kriminalizon të gjitha format e terrorizmit, përfshirë kryerjen, ndihmën, lehtësimin, rekrutimin, trajnimin dhe shtytjen për të kryer vepra terroriste. Ai gjithashtu kriminalizon fshehjen ose moslajmërimin e terroristëve ose grupeve terroriste, organizimin dhe pjesëmarrjen në grupe terroriste dhe përgatitjen e veprave terroriste kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së shtetit të Kosovës. Ai e përkufizon një grup terrorist si një grup të strukturuar prej më shumë se dy personave, që ekziston për një periudhë kohore dhe i cili vepron në bashkëpunim për kryerjen e terrorizmit. Përveç kësaj, Kodi i Procedurës Penale ua ofron autoriteteve të gjitha kompetencat e nevojshme për t'i hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e tilla, përfshirë mundësinë për të përdorur masa të fshehta si përgjimi, agjentët e fshehtë, zbulimi i të dhënave financiare dhe përgjimi i komunikimeve kompjuterike. Ai më tej u jep autoriteteve fleksibilitet për t'i hetuar aktivitetet kriminale gjatë fazës së planifikimit për t'i parandaluar krimet dhe aktet terroriste. Kodi i Procedurës Penale gjithashtu u lejon gjykatave të Kosovës të pranojnë prova nga vendet e tjera, duke lejuar kështu ndjekjen penale të terrorizmit ndërkombëtar në Kosovë. Kjo kornizë ua ofron autoriteteve përkatëse mjetet e nevojshme për t'i luftuar të gjitha format e terrorizmit. Kosova gjithashtu kriminalizon bashkimin në një ushtri, polici ose formacion paraushtarak të huaj në konflikte të armatosura jashtë territorit të Kosovës dhe propagandat përkatëse. Dënimi për këto akuza është deri në 15 vjet burgim.

Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte jashtë vendit më 12 mars dhe ai hyri në fuqi më 18 prill. Asnjë arrestim nuk ishte bërë sipas këtij ligji deri në fund të vitit.

Autoritetet nuk kishin përvojë në trajtimin e rasteve të terrorizmit, dhe komunikimi dhe ndarja e informatave mbetën sfidë për organet për zbatim të ligjit. Drejtoria kundër Terrorizmit e PK-së, që është përgjegjëse për hetime kundër terrorizmit, ka kufizim të resurseve, gjë që e pengon aftësinë e saj për t'i zbuluar të dyshuarit. Ligji parashikon kompetenca ekskluzive për Prokurorinë Speciale (PSRK), e cila përbëhet nga stafi vendorë e ndërkombëtarë, për raste të terrorizmit. Prokurorët kanë përparuar dukshëm gjatë vitit të kaluar në trajtimin e rasteve që lidhen me terrorizëm.

Departamenti i Shtetit mbështeti programe me Departamentin e Drejtësisë për t'i mentoruar organet e Kosovës për zbatim të ligjit dhe prokurorët e Kosovës. Kosova është anëtare e Qendrës së Asistencës Rajonale për Kontroll, Verifikim dhe Implementim të Armëve (RACVIAC), një organizatë e Evropës juglindore që përqendrohet në çështje të sigurisë, përfshirë terrorizmin. Përfaqësues nga Kosova morën pjesë në aktivitete trajnimi dhe konferenca, të sponsorizuara nga BE-ja dhe SHBA-ja, në tema lidhur me kundërterrorizmin.

Kosova lëshon dokumente biometrike të udhëtimit dhe identifikimit që nga viti 2013. Të gjitha vendkalimet kryesore kufitare, përfshirë Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, janë të pajisura me pajisje të kompjuterizuara për identifikimin e dokumenteve të falsifikuara / ndryshuara, për të cilën databaza azhurnohet rregullisht me informata nga vendet e tjera. Në listat e ndalimit/kontrollit të azhurnuara rregullisht të Policisë Kufitare të Kosovës (PKK) për persona për të cilët dyshohet se kanë lidhje me aktivitetet terroriste ose kriminale ishin mbi 1700 persona në vitin 2015. Megjithatë, sistemi elektronik për menaxhimin e kufirit nuk ndërlidhet me Interpolin dhe nuk funksionon gjithmonë siç duhet. Kosova nuk është anëtare e OKB-së, Interpolit apo Europolit; Misioni i OKB-së në Kosovë dhe EULEX-i shërbejnë si ndërmjetës të Kosovës me këto organizata, duke ngadalësuar kështu bashkëpunimin dhe pengimin e Kosovës për të pasur qasje në listat e tyre të kontrollit. Kosova ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në Interpol, por po përballet me kundërshtim nga Serbia dhe shtetet e tjera që nuk e kanë njohur.

PKK dhe Drejtoria Kundër Terrorizmit përdorin pajisje biometrike për t'i regjistruar të huajt e dyshimta që hyjnë apo konkurrojnë për përfitime në Kosovë, si dhe vendorët që mund të jenë të lidhur me terrorizmin. Ligji për Kontrollin e Kufirit i obligon kompanitë ajrore t'i dërgojnë informatat paraprake për udhëtarë, emrin e kompanisë ajrore, emrat e udhëtarëve në Kosovë; PKK është duke e përdorur këtë informatë. PKK zbaton teknika specifike të profilizimit për t'i identifikuar personat që përpiqen të udhëtojnë në Siri dhe Irak për t'iu bashkuar ISIL-it. Në vitin 2015, PKK, në bashkëpunim me vendet e rajonit dhe Turqinë, i ka identifikuar dhe ndaluar së paku 10 persona të tillë për t'u larguar nga Kosova dhe ia ka dorëzuar Drejtorisë Kundër Terrorizmit të PK-së. Me ndihmën e SHBA-së, PKK po i rishikon kurikulat e veta që përdoren për t'i trajnuar zyrtarët kufitarë për t'u përqendruar më tepër në identifikimin e hershëm të personave të lidhur me terrorizmin. Programi i Departamentit të Shtetit për Ndihmë Kundër Terrorizmit ka përkrahur pjesëmarrjen e Kosovës në një sërë kursesh lidhur me sigurinë kufitare, të cilat kanë për qëllim adresimin e udhëtimit të luftëtarëve të huaj terroristë.

Gjykimet janë duke vazhduar për disa prej 59 të dyshuarve të arrestuar në gusht të vitit 2014 gjatë operacionit më të madh të Qeverisë së Kosovës kundër terrorizmit deri më sot. Janë ngritur tri aktakuza kundër 33 personave. Shumë prej të pandehurve u deklaruan fajtorë për akuzat ndaj tyre. Prokurorët e Kosovës ngritën aktakuzë kundër gjashtë personave të tjerë në vitin 2015, të cilët ishin arrestuar nga EULEX-i në qershor të vitit 2014 në lidhje me një rast të veçantë. Hetimet janë duke vazhduar kundër dhjetëra individëve, përfshirë disa imamë. Gjatë vitit 2015, autoritetet e Kosovës hapën 20 raste të reja kundër 45 të dyshuarve. Policia arrestoi 14 prej këtyre të dyshuarve. Më 11 korrik 2015, PK arrestoi pesë individë afër Prishtinës nën akuzat për terrorizëm. Më 1 dhjetor, policia italiane arrestoi dhe ekstradoi dy shqiptarë të Kosovës dhe PK arrestoi personin e tretë në Kosovës, që dyshohej të ishte anëtar i një celule terroriste që kishte kërcënuar Papën dhe ish-ambasadorin e SHBA-së në Kosovë.

Në tetor të vitit 2015, ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës lëshoi një urdhër ekzekutiv me të cilin ua revokonte lejet 16 OJQ-ve nën dyshimin për rekrutim për ISIL dhe përhapje të propagandës ekstremiste.

Kosova tregoi vullnet politik për t'i trajtuar kërcënimet lidhur me terrorizmin dhe shteti posedon kornizën ligjore për ta bërë një gjë të tillë. Megjithatë, institucionet shtetërore -- përfshirë elementet e hetuesisë dhe prokurorisë -- kanë kapacitet, burime dhe përvojë të kufizuar për t'i trajtuar rastet e terrorizmit me efikasitet.

Kundërvënja financimit të terrorizmit: Kosova nuk është anëtare e Task Forcës për Veprim Financiar (TFVF). Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës (NJIF) punoi për t'u bërë anëtare e Egmont Group. Kosova ka një ligj për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i cili i mundëson të veprojë në pajtim me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parave dhe financimit të kundërterrorizmit. Ky ligj gjithashtu krijoi mekanizma zbatues për ekzaminimin e subjekteve raportuese dhe e përkufizon ngushtë financimin e terrorizmit. Megjithatë, asaj i mungon sistemi përkatës për regjistrim dhe monitorim për t'i zbuluar OJQ-të që marrin mjete financiare nga subjektet e dyshimta. Legjislacioni, ndryshimet dhe direktivat e tjera janë në pritje të financimit kundër terrorizmit dhe indikatorëve të saj. Kosova ende nuk e ka ndjekur penalisht me sukses një rast të financimit të terrorizmit apo identifikuar dhe ngrirë asetet e individëve dhe organizatave të sanksionuara. Për informata të tjera mbi pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, shih Raportin e vitit 2016 për Strategjinë Ndërkombëtare të Kontrollit të Narkotikëve (INCSR), Vëllimi 2, Pastrimi i Parave dhe Krimet Financiare: <http://www.state.gov/j/inl/rls/nrcrpt/index.htm>.

Luftimi i ekstremizmit të dhunshëm: Njëra prej katër objektivave strategjike në strategjinë e qeverisë për CVE është parandalimi i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, të cilin qeveria filloi ta zbatojë në nëntor. Këtu përfshihet ngritja e vetëdijesimit për radikalizmin ndër palët e interesuar të komunitetit dhe ndërtimi i kapaciteteve të tyre për ta luftuar atë, rritja e mbështetjes për rininë, kundër mesazhet, përfshirja e CVE-së në nismat ekzistuese të komunitetit, ndërmarrja e aktiviteteve rajonale për CVE dhe krijimi i një plani strategjik të komunikimit. Strategjia e Kosovës për CVE gjithashtu përfshin përgatitjen dhe mbështetjen e kundër-narracioneve për ta dobësuar vlefshmërinë e mesazheve të ekstremizmit të dhunshëm.

Strategjia e Kosovës për CVE përfshin një pjesë për deradikalizimin dhe riintegrimin e personave të radikalizuar. Në këto qëllime përfshihen ndihma që personat e radikalizuar ta braktisin ideologjinë e ekstremizmit të dhunshëm, vlerësimi i rrezikut që paraqitet nga individët që kthehen nga konfliktet e huaja (të përfshihen alternativat ndaj paraburgimit, sipas nevojës, dhe mbështetja psikologjike), ngritja e vetëdijesimit brenda sistemit korrektues mbi rreziqet që paraqiten nga terroristët e burgosur dhe ndërtimi i kapaciteteve për rehabilitimin e tyre. Qeveria filloi të punojë në këtë drejtim në nëntor.

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar: OSBE-ja dhe Sektori për Parandalim të Terrorizmit i Zyrës së OKB-së për Droga dhe Krime u ka ofruar organeve të Kosovës për zbatim të ligjit, prokurorëve dhe gjykatësve të Kosovës trajnim në temat që lidhen me terrorizmin. Anëtarësimi i Kosovës në shumë organizata rajonale dhe ndërkombëtare, përfshirë OKB-në, është bllokuar nga vendet që nuk e njohin pavarësinë e saj. Mungesa e anëtarësimit dhe mosnjohja pengon bashkëpunimin në shumë çështje, përfshirë kundërterrorizmin. Mosnjohja e Kosovës nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina e pengon pjesëmarrjen e saj në shumë nisma rajonale kundër terrorizmit.

Disa zyrtarë të Kosovës kanë marrë pjesë në Samitin e Shtëpisë së Bardhë mbi luftën kundër ekstremizmit në shkurt dhe në Samitin e liderëve mbi luftë kundër ISIL-it dhe ekstremizmit të dhunshëm, nikoqir i të cilave ishte Presidenti Obama në Nju Jork në shtator dhe në një samit rajonal mbi CVE-në në Tiranë, Shqipëri, në maj. Kosova është zgjedhur si vend përfitues për Fondin global të angazhimit dhe aftësinë ripërtëritëse të komunitetit (GCERF), e cila do t'i financojë iniciativat në nivel të komunitetit që kanë për qëllim reduktimin e rrezikut të radikalizmit të dhunës.